

# **VESHJET TRADICIONALE DHE KOMBËTARE NE MALËSINE E GALLAPIT (GOLLAKUT)**

Prof. mr. sc. Murat AJVAZI

Akademia “Rrënjët Tona”

## **PËRMBLEDHJE**

Malësija e Gallapit si tërësi gjeografike, etno-kulturore dhe historike shtrihet në pjesën qendrore dhe verilindore të Dardanisë duke përfshirë një territor të madhë. Në lindje shtrihet deri në malet buzë Bujanocit, duke shkuar nga lindja deri në rrafshin e luginës së Moraves jugore përfshirë këtu edhe luginën e Jabllanices, pergjatë Lebanes, Kurshumlisë dhe Leskocit dhe në veri përfshinë malet e Albanikut që në hartat sllave janë të shënuara Koapavnike, deri tek rrjedhja e sipërme e lumit Toplicë. Territori i sotëm i Gallapit administrativisht i takon komunave të Besjanës (Podujeves), Prishtinës, Artanës (Novobërdë), Gjilanit, dhe Dardanës (Kamenices).

*Fjalë kyçe: veshje tradicionale, komb, malesi, lumë, jelek.*

## **ABSTRACT**

The Gallup highland, as a geographical ethno-cultural and historical whole lies in the central and northeastern part of Dardania including a large territory. In the east it lies in the mountain near Bujanovac, going east to the plain of the southern Morava valley including the Jablanica valley along Lebanon, Kursumlija and Leskovac and to the north it includes the Albanik mountains which in Slavic maps are marked as Koapanike, up to the upper flow of the river Toplice. The traditional Gallapian customs of both genders were traditional national customs inherited from generation to generation. They had a complete structure for all ages. It was simple and made mainly from local raw material from sheep, goat wool and rarely from cotton. In Gallup are worn “tireqit” called “Galana” (black color), made of black sheep wool with black braids of 3-18 threads, depending on the economic situation and the age of the wearer. The material for them was worked in “veke” by Albanian women, then they were sent to a kind of workshop (mechanism called “Valavice”) that worked with river water as a kind of mill. Such have existed in the village of Hajkobilje, Prapashtice, Krileve, Marec, and many other places. In Gallup the zhguns were compressed after drying where they were cut and sewn by some people called terezinje. In Gallup were worked also: Mahrama, Xhurdija, Shokat, Kemishat, Mintanet and Jeleket, Dimijat, Peshtjellaku, Shamiat, Corapet, etc.

*Key words: traditional clothing, nation, highland, river, vest.*

## **HYRJE**

Veshjet e banorëve të Gallapit te dy gjinive ishin veshje tradicionale kombëtare të trashëguara brezë pas brezi. Ato kishin një strukturë të plotë për çdo moshë. Ishte e thjeshtë dhe e punuar kryesisht nga lënda e parë vendore nga leshi i deleve, dhijeve dhe rrallë herë nga pambuku. Në Gallup meshkujt bartnin tirLqit të quajtur “Galana” (ngjyrë zeze), punuar nga leshi i deleve të zeza me gajtan të zi prej 3-18 fije, varësisht nga gjendja ekonomike dhe mosha e bartësit. Materiali për ta është punuar në vekë nga gratë e shtëpive, pastaj janë dërguar tek një llojë puntorie (mekanizmi i quajtur “Valavice”) që ka punuar me ujë të lumit si llojë mulliri. Të tilla kanë ekzistuar në fshatin Hajkobilje, Prapashticë, Krilevë, Marec, Meshinë, Shipashnicë e shumë vende të tjera. Në Gallup zhgunat janë ngjeshur pas tharjës ku nga to jane

prerë dhe qepur nga disa njerëz të quajtur terëzinje. Poashtu në Gallup janë punuar: Plisi, Mahrama, Xhurdija, Shokat, Këmishat, Mintanet, Jelekët, etj.

## **VESHJET TRADICIONALE DHE KOMBËTARE NE MALËSINE E GALLAPIT (GOLLAKUT)**

### **Plisi**

Plisi punohej në vekë me pejë të tjerrur nga leshi i deleve i cili shkelej (ngjeshej) mirë dhe pastrohej disa herë me sapun. Në Gallup përdorej plisi në formë të rrumbullaket por edhe i rrafshët, ky plis punohej në Prishtinë, Gjilan, Gjakovë, Pejë nga qeleshpunuesit.

### **Mahrama**

Në Gallup janë bartur shumë Mahrama, për ta mbrojtur kokën nga të ftohtit. Punoheshin në Vekë me një gjatësi rreth 1m e 50cm, dhe e gjerë 40cm. Punohej nga penjët e bardhë të pambukët, me vija grupe grupe të bardha të vendosura vertikalisht.

### **Xhurdija**

Xhurdija është përdorur nga leshi i deleve e cila punohej në vekë. Punoheshin Xhurdijë me mëngë dhe pa mëngë, të cilat dekoroheshin me fije gajtani. Visheshin së bashku me tireqet si sot xhaketat (setrat), të cilat konsiderohen si veshje shumë e lashtë, të përdorur nga fiset Ilire-Shqipetare.

### **Shokat**

Ishin pjesë e veshjeve kombëtare që visheshin me tirqe e xhamadan, të punuara në vekë nga gratë e asaj kohe. Në fillim punoheshin nga leshi e më vonë nga pambuku. Këto shërbenin në rradhë të parë, për mbështjelljen e brezit të trupit, por edhe si veshje zbukuruese. Në Gallup për të rinjët, shokat ishin me shumë harqe (ngjyra), dallohej më së shumti ngjyra e kuqe, kurse tek të moshuarit mbanin shokat me ngjyrë të mbyllët, dhe me laramani ngjyrash.

### **Këmishat**

Meshkujt e Gallupit kanë veshur këmishat nga pëlhura e pambukut e cila punohej në vekë dhe nga një lloj i ashtuquajtur “basme”, e cila blehej nëpër dyqanet e tekstilit. Këmishat i qepnin gratë Gallapase.

### **Mintanët dhe Jelekët**

Gallapasit kanë veshur mintanë dhe jelekë të cilat janë qepur nga një lloje materiali (shtofi) i zi, ku për rethe jakëve stoliseshin me disa tegele me penjë te zi. Përpara i kishin xhepat për ti vendosur orat me zinxhirë (qystek).

### **Veshjet e femrave Gallapase**

Veshjet e femrave Gallapase ishin këmisha e gjatë e punuar në fillim prej lini, pambuku, dhe nga mëndafshi. Të cilat zbukuroheshin me dekorime të ndryshme të punuara me dorë nga femrat Gallapase. Veshje të tjera ishin: Dimijat, Mintani, Pshtjellaku, Shamia, Corapet etj, të cilat punoheshin me vekë dhe punëdore. Femrat më të njohura qe punonin si vekatore ishin: Naxhije Zeneli(Dabishec), Tusha Krasniqi(Meshine), Bahtije Kadriu(Strezovc), Feride Vitija (Marec), Habibe dhe Pashije Ajvazi (Hajkobillë), Bedrie Tahiri (Hajkobillë), Shemsie Krasniqi (Makoc) etj.

## **Veshjet tradicionale të Gallapit në syrin e studiuesit dhe institucioneve Serbe**

Me veshjën tradicionale të Gallapit, janë marrë edhe studiuesit dhe institucionet Serbe. Shkenca serbe e ishte në shërbim të politikës shtetërore shoveniste dhe perpiqej që me çdo kushtë të përvetsonte një pjesë të veshjeve Ilire-shqipëtare si për shembull: tirqet, shokat, mahramat etj. Para disa kohësh arriti të përvetsojë instrumentin muzikor Lahuten, dhe të mohoj me çdo kusht prejardhjen Ilire të shqipëtareve, dhe shqipëtarët ti paraqes si joautoktonë. Akademia serbe e shkencave angazhoj një ekip studiuesish për të bërë hulumtime, studime etnografike historike për vendbanimet dhe prejardhjen e popullsisë së Gallapit. Ata arritën ta botojnë edicionin me titull “Naselje i porekllō stanovnistva” (Vendbanimet dhe prejardhja e popullsisë), në të cilën i kishin marrë faktet jo të vërteta, tashmë të cilat i kurdisën vetë kundër trashëgimisë kulturore materiale, dhe shpirtërore, të trungut Pellzag-Epir-Ilir-Arbnor dhe shqipëtarë ndër shekuj. Të tillë ishin edhe Jovan Cvijiq, Urosheviq, Me dy librat e tijë (Novobërcka, Kriva Reka), Juzhna Morava Izmornik, Dimitrije Bogdanoviq me librin e tijë “Kniga o Kosovo”, Dusan Batakoviq “Kosovo i Metohija u srpsko – Arbanashkim Odnosima” e botuar në Prishtinë në vitin 1991 etj. Por falë disa studiuesve dhe udhëpërshkruesve europian si Hani, Durhami, Nopqa, Mallkomi, Robert Elsie, Statmuller, Gerd Robel, Karl Oestreich, Babinger dhe disa autore shqipëtare si akademik Ali Hadri, Skender Rizaj, Shukri Rrahimi, Emin Pllana, Masar Kodra, Pëllumb Xhufi, Muhamet Ternava, Injaz Zamputi, Zija Shkodra, Selami Pulaha, Ligor Mile, Muzafer Korkuti, etj., të cilët në punimet e tyre i hedhin poshtë të gjitha përpjekjet e autorëve serb, duke i quajtur veshjet tradicionale kombëtare shqipëtare të Gallapit, si veshje e trashëguar, të ruajtura brezë pas brezi.

### **PËRFUNDIME**

Falë disa studiuesve dhe udhëpërshkruesve europian si Hani, Durhami, Nopqa, Mallkomi, Robert Elsie, Statmuller, Gerd Robel, Karl Oestreich, Babinger dhe disa autore shqipëtare si akademik Ali Hadri, Skender Rizaj, Shukri Rrahimi, Emin Pllana, Masar Kodra, Pëllumb Xhufi, Muhamet Ternava, Injaz Zamputi, Zija Shkodra, Selami Pulaha, Ligor Mile, Muzafer Korkuti, etj, të cilët në punimet e tyre i hedhin poshtë të gjitha përpjekjet e autorëve serb, duke i quajtur veshjet tradicionale kombëtare shqipëtare të Gallapit, si veshje e trashëguar, të ruajtura brezë pas brezi.

### **STUDIME MBËSHTETËSE DHE REFERENCA**

- 1) Ali Berisha, Gallapi i Prishtinës Libri i 8-të, Prishtinë 2014,
- 2) Branislav Nusic, Kosovo-Opis zemle inaroda, Novisad 1902,
- 3) Dimitrije Bogdanovic, Kniga o Kosovo, Beograd 1990,
- 4) Djoko Slijepcevic, Srpsko-Arbanaski Odnosi kroz vekove sa posebnim osvrtom na novije vreme, Munchen 1974,
- 5) Edgar Hosch, Geschichte der Balkan Lander, Munchen 2002,
- 6) Franc Baron Nopqa, Udhetime nëpër ballkan, Tiranë 2007,
- 7) Grup autoresh, Gallapi gjatë rrjedhave të historisë, Prishtinë 2010,
- 8) Instituti Albanologjik i Prishtinës-Trashegimia dhe transformimi i kultures popullore, Prishtinë 1983,
- 9) Ivan Bozhiq, Sima Cirkoviq, Milorad Ekmeqiq, Vladimir Dedier, Istorija Jugoslavije, Beograd 1972
- 10) Mark Milan, Jeta dhe zakonet e shqipëtareve, Tiranë 1995,
- 11) Mihael Weithmann, Balkan Kronik, Kölnë 2000
- 12) Murat Ajvazi, Hajkobilla (Gjelbrishët) Monografi, Prishtinë 2021,

- 13) Milivoje Savic, Zanati i industrija u Prisajedinjenim obllastima i zanati u starim granicama  
Kralvine Serbije, Beograd 1914,
- 14) Johan G.vonHahn, Neper viset e Drinit dhe te Vardarit, Prishtine 2006,
- 15) Petrit Imami, Serbi i Albanci kroz vekova, Beograd 2017,
- 16) Robert Elsie, Kosovo A Documentary History From The Balkan Wars To World War II, Prishtinë  
2018,
- 17) Starine Kosova, libri i 10-të, Prishtinë 1997,
- 18) Skender Gashi, Emrat e Shqiptareve ne shekullin 13-15 në driten e burimeve kishëtare Serbe,  
Prishtinë 2014
- 19) Xhemail Gerbeshi, Mareci Monografi, Prishtinë 2016